

# Procesi dhe hapat themelorë në përcaktimin e tarifave të rregulluara: përmbledhje

Csaba Kovács  
Zyra Hungareze për Energji

Trajnimi i NARUC/ERRA mbi Rregullimin e  
Energjisë dhe Përpilimin e Tarifave  
**UNMIK/KOSOVO**  
5-8 nëntor 2007

## Përmbajtja e prezantimit

- Analizë financiare e aktiviteteve të rregulluara
- Deklarata Financiare Vjetore (raporti kontabilar)
- Raportet financiare
- Parimet kryesore të rregullimit të tarifës
- Hapi 0.: Sajimi i modelit të tregut
- Hapi 1.: Kalkulimi i të kërkesës për të hyra
- Hapi 2.: Parashikimi i sasive
- Hapi 3.: Përshtatjet gjatë periudhës së çmimeve të rregulluara

## Analiza financiare e aktiviteve të rreguluara

Një nga detyrat më të rëndësishme gjatë detyrës së “rregullimit të çmimit” apo “përcaktimit të tarifës” është **analiza financiare** e firmave (aktiviteve) të rreguluara.

Kjo bartë tri caqe kryesore:

- Mbledhjen e informatave (të dhënat) për përcaktimin e tarifës.
- Kontrollimi dhe prapaveprimi i tarifave ekzistuese (përkrahje për rregullimin “në vrap” të çmimeve: X-faktori, profiti maksimal, rishqyrtimi individual i kostos, etj.).
- Posedimi i të dhënave të azhurnuara mbi çështjet aktuale (debatet me firma, pyetjet nga politikanët dhe/ose konsumatorët, publikimet).

## Deklarata Financiare Vjetore

Burim themelor për të dhëna në analiza financiare është Deklarata Financiare (raporti vjetor) i kompanive të rregulluara.

Pjesë të deklaratave financiare janë:

- **Bilanci i gjendjes:** deklaratë e vlerës në letër të kompanisë në një datë të caktuar (fund të vitit fiskal).

E vetmja deklaratë që zbatohet në një moment të vetëm, e jo gjatë një periudhe kohore (gjithashtu quhet “fotografi çasti” e situatës financiare të kompanisë).

Klasifikon pasurinë e kompanisë në dy mënyra: sipas kohës së shfrytëzimit (asetet aktuale apo fikse) dhe mënyrës së financimit (kapitali aksionar dhe obligimet).

Totali i asetëve = Kapitali aksionar + Obligimet

## Deklarata financiare vjetore

### Bilanci i gjendjes së DEMASZ më 31 dhjetor 2005 (milion HUF)

<i>Asete</i>	31/12/2004	31/12/2005	<i>Obligimet dhe kapital</i>	31/12/2004	31/12/2005
<b>Asete fikse</b>	<b>65 976</b>	<b>67 805</b>	<b>Kapital</b>	<b>44 518</b>	<b>45 160</b>
<b>Asetet aktuale</b>	<b>7 547</b>	<b>7 588</b>	<b>Provizione</b>	<b>547</b>	<b>1 186</b>
inventar	617	364	<b>Obligime</b>	<b>23 036</b>	<b>22 878</b>
të pranueshme	6 147	6 726	Afatgjata	5 353	5 303
letra me vlerë	62	2	Afatshkurta	17 683	17 576
Asete likuide	720	497			
<b>Shpenzime të parapaguara</b>	<b>4 535</b>	<b>4 394</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>9 956</b>	<b>10 563</b>
<b>TOTAL ASETE</b>	<b>78 058</b>	<b>79 787</b>	<b>Totali i obligimeve dhe kapitalit</b>	<b>78 058</b>	<b>79 787</b>

## Deklarata Financiare Vjetore

Pjesa e parë e deklaratës së të hyrave të DEMASZ, viti 2005, në milion HUF

Të ardhurat dhe shpenzimet	2004	2005
Total shitje	81 593	83 876
Të ardhura tjera	1 806	1 691
Kostoja e materialit	61 723	62 999
Shpenzime për personel	5 822	6 157
Amortizim	7 532	7 741
Shpenzime tjera	2 001	2 623
<i>Profit operativ</i>	<i>6 321</i>	<i>6 047</i>

## Deklarata financiare vjetore

Pjesë të deklaratës financiare janë (2):

- **Deklarata e të ardhurave** (llogaria e profitit e humbjes – P&L): regjistron të ardhurat dhe shpenzimet brenda një periudhe të caktuar kohore (zakonisht brenda një viti).

Tregon se si të ardhurat janë transformuar në të hyra neto (rezultati pasi të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet të jenë llogaritur).

P&L është një qasje e raportimit të rezultateve të kompanisë pa përfshirë të hollat e gatshme.

## Deklarata financiare vjetore

Pjesë të deklaratës financiare janë (3):

- Deklarata e rrjedhës së keshit: që i referohet vlerave të keshit të cilat pranohen dhe shpenzohen gjatë një periudhe të caktuar kohore (zakonisht për një vit)

Zakonisht shfrytëzohet për të identifikuar problemet me likuiditet. Mungesa e keshit mund të paraqitet edhe kur kompania është profitabile (dhe e kundërta)!

RRK operacional: rezultat i afarizmit kyç të kompanisë

RRK investues: rezultat i investimeve dhe blerjeve.

RRK financues: rezultat i aktiviteteve financiare (pranimi apo pagimi i kredive, lëshimi i aksioneve, pagimi i dividendëve, etj.)

## Deklarata financiare vjetore

Pjesë të deklaratës financiare janë (4):

- **Shënimet në deklaratën financiare:** pjesë shtesë e deklaratës financiare, që i ndihmon lexuesit duke i ofruar informata më të detajuara.

Në të përfshihen informata kontekstuale të cilat sqarojnë figurat financiare.

Mos i hidhni shënimet nëse nuk keni kohë t'i lexoni ato! Shpesh ato janë i vetmi dokument i cili ju ndihmon t'i kuptoni si duhet të dhënat që ofrohen me shifra!

## Deklarata financiare vjetore

### **Përse janë deklaratat financiare të dobishme për rregullatorët?**

- DF përgatitet në pajtim me rregullat e përgjithshme të përcaktuara me ligj. Kësisoj, mundësohet krahasimi i raporteve të kompanive të ndryshme.
- DF auditohet nga kontabilistët.
- DF nuk përgatitet veçanërisht për rregullatorin, raporti vjetor mund të vlerësohet si publikim real dhe i besueshëm.
- Janë publikisht në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara për performansën financiare të kompanisë.
- DF zbulon një pasqyrë të performansës ekonomike të kompanisë.

## Deklarata financiare vjetore

### **Cilat janë problemet lidhur me deklaratat financiare?**

- Në kuadër të rregullave të përgjithshme të kontabilitetit janë të lirë t'i vlerësojnë asetet dhe përgjegjësitë e tyre (politikat e kontabilitetit). Rrjedhimisht limitohet edhe krahasimi.
- DF i referohet kompanisë së gjithmbarshme, zakonisht të integruar vertikalisht dhe aktivitetet e rregulluara nuk ndahen.
- DF përgatitet dhe publikohet një herë në vit.
- Politikat e rregullimit të çmimit të rregullatorit nuk janë në pajtim me politikat kontabilare të brendshme të kompanisë (problemi i kostove dhe aseteve të arsyeshme).

## Deklarata financiare vjetore

### Zgjidhja mund të jetë...

- Deklarata financiare është e përshtatshme për monitorim të vazhdueshëm ekonomik e edhe si pikënisje për rregullim të çmimit.
- Shpërbërja (ndarja) e bizneseve të reja.
- Mungesa e shpërbërjes ligjore, rregulla të ndara kontabilare të lëshuara nga rregullatori (p.sh. direktiva mbi ndarjen e kontabilitetit).
- Furnizim më i shpeshtë me të dhëna ekonomike nga bizneset e rregulluara (p.sh. Llogari tremujore të profitit dhe humbjeve).
- Në rast të kompanive që janë të listuara në bursë, mbledhja e raporteve të shkurta (rregullat e bursës janë tejet strikte).

## Normat financiare

Është tipike që deklaratat financiare të analizohen përmes shfrytëzimit të normave. Normat financiare formohen nga dy apo më shumë vlera të nxjerra nga bilanci i gjendjes apo nga deklarata e të ardhurave.

Ato shfrytëzohet gjithashtu nga huadhënësit (për analizimin e rrezikut të kredisë), afaristët (për vlerësimin e projektit) apo përzgjedhësit e bursës (për analizimin e së performansës nga e kaluara dhe parashikimin e performansës në të ardhmen).

Këto norma krahasuese mundësojnë krahasimin mes:

- kompanive apo departamenteve,
- industrive,
- periudha të ndryshme kohore të kompanisë (analiza të trendit),
- mesataret e kompanisë apo industrisë.

## Normat financiare

### **Fitimi nga asetet = profiti operativ/totali i aseteve**

Indikator lidhur me atë se sa profitabile është kompania (aktiviteti)

### **Raporti mes borxhit dhe kapitalit = obligimet/kapitali**

Tregon proporcionin relativ të kapitalit dhe borxhit, që shfrytëzohet për të financuar asetet e kompanisë.

### **Raporti aktual = Asetet aktuale/obligimet aktuale**

Tregues i likuiditetit të një firme në treg dhe mundësia për t'i përmbushur obligimet afatshkurta (norma mes 1 dhe 1.5 konsiderohet si standard).

### **Raporti i shpejtë = (asetet aktuale – inventari)/obligimet aktuale**

Matë mundësinë e shfrytëzimit të asetëve të shpejta për t'i mbuluar obligimet aktuale. Raporti aktual është 1:1.

## Normat financiare

### Leksionet mbi normat financiare

- Vendimi mbi atë se cila normë krahasuese duhet shfrytëzuar (dhe si) është i natyrës subjektive.
- Zgjidhja mes normave të ndryshme krahasuese varet nga caku i analizës.
- Ju duhet të dini vlerën e normës që është tipike për industrinë e analizuar. Nuk ka në asnjë rast vlera valide!
- Analiza e normave është hapi i parë që duhet ndërmarrë për të fituar një pasqyrë të qartë mbi performansën ekonomike të industrisë (kompanisë). Pas kalkulimit të normave krahasuese, është e domosdoshme që të shtjellohen mirë shifrat për të kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe pse.

## Parimet kryesore të rregullimit të tarifës

- **Çmimet nuk duhet rrezikuar rentabilitetin financiar të kompanive të rregulluara.** *Të gjitha kostot e justifikuara duhet të mbulohen, përfshirë edhe koston e asetëve kapitale.*
- **Rregullimi i çmimit duhet të stimulojë funksionimin më efikas.** *Duhet gjithashtu të merret si cak efikasiteti produktiv dhe alokativ – rregullimi i çmimeve stimuluese.*
- **Rregullimi i çmimeve duhet të jetë transparent dhe konsistent.** Thjeshtësia e strukturës mund të përcaktojë nivelin e besimit tek rregullimi.
- **Duhet shmangur intervenimet e shpeshta dhe të papritura.** Rregullatorët janë gjithmonë në situatë që përballen me informata joperfekte.

## Hapi 0: Ndërtimi i modelit të tregut

- Njohja e tregut – të qenit në ngjarje!
- Cka dëshironi të rregullin? Pse? Sa gjatë?
- Krijoni modelin e tregut dhe përcaktoni metodologjinë më të përshtatshme për rregullim të çmimit!
- Diskutoni dhe vëni në letër – të keni kushte të barabarta të lojës!
- Filloni së punuari (apo le tua përgatit dikush) që tani!

## Hapi 1: Kalkulimi i kërkesës për të hyra (1)

**Kërkesat për të hyra** (RR) janë të ardhura (profit) dhe kosto njëkohësisht (firmat kundrejt konsumatorëve).

Kalkulimi i tyre zakonisht paraqet hapin e parë e të gjitha metodologjive të njohura të rregullimit të çmimit (metodologjia e normës së fitimit – gjithashtu të njohur si rregullimi i kostos-plus), apo kostoja e shërbimit, metoda e rregullimi të çmimeve stimuluese.

Ideja kryesore është që të ardhurat e kompanive të rregulluara të duhet të mbulojnë shpenzimet e tyre operative, taksat dhe amortizimin, dhe të duhet të sigurojnë një normë të duhur të fitimit (profitit) nga asetet e vëna në shërbim.

## Hapi 1: Kalkulimi i kërkesës për të hyra (2)

**Formula tipike për RR është si vijon:**

$$RR = O + D + T + r * B$$

ku

RR = Kërkesa për të hyra

O = Shpenzime operative

D = Amortizimi

T = Tatimet

r = Norma e lejuar e fitimit

B = Baza e normës tarifore (apo baza e asetëve të rregulluara – RAB)

Për kalkulimin e RR, rregullatori duhet të mbledhë të gjitha elementet e formulës (kostot e detajuara dhe asetet e shqyrtuara).

## Hapi 2: Parashikimi i kuantiteteve (1)

### ***Pasi që të kemi gjetur “numëruesin” duhet ta gjejmë “emëruesin”!***

(çmimi mesatar) i tarifës = të ardhurat/kuantiteti

„Rrethana të vështirësuara”:

- Elemente me kosto fikse dhe të ndryshueshme
- Kushtet e ardhshme mjedisore
- Portofoli i gjenerimit, tregtia ndër-shtetërore
- Struktura e konsumit (uniform kundrejt tarifave rajonale)
- Të dhënat nga e kaluara dhe parashikimet për ngritje (rënie)
- Asimetria informative

## Hapi 2: Parashikimi i kuantiteteve(2)


Shembull: Alokimi i kostove të distribucionit për nivele të tensionit

Qendra e kostos	Proporcioni i kostove HVL	Proporcioni i kostove HVL/MVL	Proporcioni i kostove MVL	Proporcioni i kostove LVL
	8%	18%	24%	50%
Disitribucioni i energjisë elektrike që rrjedh jashte	60%	71%	76%	100%
	22%	26%	24%	
	3%	3%		
	15%			

## Hapi 2: Parashikimi i kuantiteve (3)

### Shembull: Struktura e tarifës së distribucionit (Hungari)

#### Pagesat e distribucionit (nivel të voltazhit)



## Hapi 3: Përshtatjet

- Tarifat fillestare
- Shtrirja e periudhës së rregullimit të çmimit (intervali rregullues)
- Përshtatjet ‘normale’ (pa befasi për akterë të tregut)
  - Stimulues për cilësi
  - Ndarja e përfitimeve
  - Elementet kaluese
- Korrigjimet „në kalim” (befasia dhe ndikimi në të ardhmen)
  - Rishqyrtimi individual i kostos (investime të reja)
  - Diçka shkoj keq (kontratat TOP, tarifat sociale, etj)

**DHE JU MUND TË FILLONI PRAPË ME NJË PERIUDHË TË  
RE TË RREGULLIMIT TË ÇMIMEVE!**

Ju falemnderit për vëmendje!

Csaba Kovács

[kovacscs@eh.gov.hu](mailto:kovacscs@eh.gov.hu)

+36-1-459-7747